



UNIVERSITETI I TIRANES
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE



FILLIMI RRETH FAKULTETIT » DEPARTAMENTET » STUDENTET » KERKIMI DHE BOTIME » NJOFTIME DHE NGJARJE GALERIA KONTAKT

PROJEKTE BASHKEPUNIMI

ERASMUS+ MUNDUS – ELA

RRETH PROJEKTTIT	PARTNERËT E PROJEKTTIT	EKIPI I PROJEKTTIT I FSHS	VEPRIMTARI NDËRKOMBËTARE
VEPRIMTARI LOKALE	PUBLIKIME	MATERIALE MËSIMORE	FOTO DHE VIDEO GALERI
			KONTAKT

Veprimtari të vitit 2018

7-8 qershor 2018, Bialystok, Poloni

Ekipi i FSHS, i përbërë nga Edmond Rapti, Theodhori Karaj, Nikoleta Mita, Livia Nano dhe Nada Kallçiu mori pjesë në Konferencën e pranverës të ATEE me temë "Ideimi i formimit dhe zhvillimit profesional të mësuesve për shekullin e 21-të: prirjet aktuale, sfidat dhe drejtimet për të ardhmen", organizuar në Bialystok, Poloni. Një seancë e posaçme në këtë konferencë iu kushtua ndikimit të projektit EduLAW në programet e mësuesisë.

Ekipi i FSHS bëri tre prezantime në këtë konferencë. Theodhori Karaj dhe Edmond Rapti prezantuan kumtesën me temë "Motivimi i studentëve të mësuesisë për zgjedhjen e mësuesisë si profesion"; Livia Nano, Nada Kallçiu dhe Nikoleta Mita prezantuan kumtesën me temë "Pikëpamjet për t'u bërë mësues: rasti i studentëve të mësuesisë në Shqipëri"; Nikoleta Mita paraqiti prezantimin "Ndikimi në këndvështrimin pedagogjik i projektit EduLAW në programet e mësuesisë dhe të shkencave të edukimit të UT-së".

Gjatë ditëve të konferencës, ekipi i Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës mori pjesë aktive në të gjitha seancat me pyetje dhe komente. Gjithashtu, ekipi i FSHS pati edhe bisedime me kolegë të universiteteve të ndryshme nga e gjithë bota për bashkëpunime në fushën e programeve të studimit të mësuesisë dhe të psikologjisë. Gjatë konferencës u krye vlerësimi i brendshëm i cilësisë dhe u mbajt takimi i komitetit drejtues të projektit.



4-5 qershor 2018, Minsk, Bjellorusi

Nga 4-5 qershor 2018, në kuadrin e projektit ELA, u mbajt në Minsk të Bjellorusisë seminari për pasqyrimin në kurrikulat e programeve të mësuesisë dhe të shkencave të edukimit të dimensionit ligjor të arsimit. Pjesëmarrësit në këtë veprimtari prezantuan mënyra të ndryshme të përfshirjes së moduleve të EduLAW në programet e studimeve të mësuesisë.

Fakulteti i Shkencave Sociale u përfaqësua nga Nikoleta Mita, koordinatore institucionale e projektit e cila prezantoi ndryshimet në tematikën dhe rezultatet e të nxënës që do të bëhen në programet mësimore të lëndëve për politikën dhe legjislacionin në arsim që ofrohen në tre programe master si dhe mundësinë e ofrimit të moduleve të legjislacionit në arsim të përgatitura në kuadrin e projektit si kurs trajnimi për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave në shërbim.

Në këtë veprimtari u përcaktuan detyrat për përgatitjen e materialeve on-line, metodologjinë e mësimdhënies dhe të të nxënës, për sistemin e testimit të moduleve të legjislacionit në arsim. Në këtë takim u planifikuan veprimtaritë e ardhshme të projektit dhe u plotësua formulari i vlerësimit të brendshëm.



Veprimtari të vitit 2017

5-10 nëntor 2017, Bialystok, Poloni

Zhvillohet internshipi i tretë trajnues në Bialystok, Poloni. Programi i këtij internshipi përbante tavolina të rrumbullakta për diskutimin e çështjeve të përmbajtjes, të rasteve dhe të strukturës të moduleve të prezantuara në dy internshipet e zhvilluara në Lituani dhe Belgjikë gjatë viti 2017.

Gjatë ditëve të internshipit ekipi i Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës mori pjesë aktive në të gjitha tavolinat e rrumbullakta. Ai prezantoi përmirësimet e bëra në dy modulet e përgatitura nga anëtarët e ekipit të tij dhe dha mendime për përmirësimin e moduleve dhe rastet e përgatitura nga kolegët e universiteteve të tjera të konsorciumit.

Nga FSHS të Universitetit të Tiranës në këtë internship morën pjesë tre pedagogë: Nikoleta Mita, Theodhori Karaj, Livia Nano.

Sipas programit të internshipit, ekipi i FSHS ndoqi ligjeratën e hapur me temë "A duhet mësuesit të kenë nivelin master? Rezultate nga një studim krahasues me studentët e mësuesisë në pesë vende evropiane" të mbajtur nga Marta Kowaiczuk-Waledziak, Universiteti i Bialystok.

Ekipi i FSHS pati edhe bisedime me kolegët të Universitetit të Bialystok për bashkëpunime dypalëshe në fushën e programeve të studimit të psikologjisë dhe të mësuesisë.

Gjatë internshipit u krye vlerësimi i brendshëm i cilësisë dhe u mbajtën takimet e komitetit drejtues të projektit.

**24 - 30 shtator 2017, Bruksel-Antverp, Belgjikë**

Zhvillohet internshipi i dytë trajnues në Bruksel dhe Antverp, Belgjikë. Programi i këtij internshipi kishte dy pjesë. Pjesa e parë u zhvillua në dy ditë në Bruksel. Gjatë dy ditëve u zhvilluan vizita dhe takime në mjediset e Komisionit Evropian dhe të Parlamentit Evropian. Prezantimet dhe diskutimet u përqendruan rreth rolit, politikave, iniciativave dhe veprimtarive të institucioneve evropiane për çështje të arsimit, të bashkëpunimit ndërkombëtar, të modernizimit të arsimit të lartë dhe të Procesit të Bolonjës. Gjatë ditëve të tjera të programit u prezantuan shtatë programet modulare, modulet përkatëse të përgatitura nga universitetet partnere në projekt dhe rastet sipas moduleve. Për çdo modul dhe rast të paraqitur u zhvilluan diskutime dhe u dhanë sugjerime për përmirësim.

Nga Universiteti i Tiranës në këtë takim morën pjesë gjashtë pedagogë të FSHS: Edmond Rapti, Nikoleta Mita, Bardhyl Musai, Gerda Sula, Livia Nano dhe Rovena Sulstarova.

Ekipi i FSHS të UT prezantoi dy module dhe pesë raste nga konteksti shqiptar i zbatimit të legjislacionit në arsim dhe dha mendime për çështjet që u diskutuan.

Nikoleta Mita dhe Livia Nano prezantuan modulën e përgatitur prej tyre me titull: "Legjislacioni për cilësinë në arsim".

Gerda Sula dhe Rovena Sulstarova prezantuan modulën e përgatitur prej tyre së bashku me Theodhori Karaj të titulluar: "Rregullimi ligjor për arsimin profesional, KEK niveli 5 dhe zbatimi i tij".

Edmond Rapti, Bardhyl Musai, Gerda Sula dhe Rovena Sulstarova paraqitën rastet nga konteksti shqiptar për kompetencat në arsim, për statusin e mësuesit, për cilësinë në arsim, për qeverisjen dhe administrimin në nivel lokal.

Gjatë ditëve të internshipit u krye vlerësimi i brendshëm i cilësisë; u ndoq seanca e mbrojtjes së hapur të doktoratës të zhvilluar në Universitetin e Antverpit, të përgatitur nga Georgia du Plessis dhe u mbajtën takimet e komitetit drejtues të projektit.

**4 - 10 qershor 2017, Kaunas, Lituani**

Zhvillohet internshipi i parë trajnues në Kaunas, Lituani. Gjatë këtij internshipi u prezantuan tetë programet modulare dhe tetë modulet e përgatitura nga universitetet partnere në projekt; u prezantuan rastet gjyqësore, administrative dhe studimore në përputhje me çështjet e moduleve. Për çdo modul dhe rast të paraqitur u zhvilluan diskutime dhe u dhanë sugjerime për përmirësim.

Nga Universiteti i Tiranës në këtë takim morën pjesë katër pedagogë: Nikoleta Mita, Theodhori Karaj, Gerda Sula dhe Livia Nano. Ekipi i FSHS të UT prezantoi pesë raste nga konteksti shqiptar i zbatimit të legjislacionit në arsim dhe dha fedback për modulet e përgatitura nga kolegët e universiteteve partnere.

Gerda Sula prezantoi rastin për procedurat disiplinore ndaj nxënësve dhe dha fedback për modulën për vlerësimin e mësuesve.

Livia Nano prezantoi rastin për diskriminimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim në Shqipëri.

Nikoleta Mita prezantoi dy raste: 1) rast gjyqësor për ndryshimin e rezultatit të provimit të maturës shtetërore të një maturanti në lëndën "Gjuhë shqipe-letërsi" për vitin 2014. 2) rast për vlerësimin e mësuesit në kuadrin e kualifikimit.

Theodhori Karaj prezantoi rastin e Vendimit të Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me zbatimin e Ligjit "Për Mbrojtjen e të dhënave personale" nga DAR Elbasan, 2016.

Gjatë ditëve të internshipit u krye vlerësimi i brendshëm i cilësisë; u zhvilluan leksione të hapura dhe u mbajtën takimet e komitetit drejtues të projektit.



2 – 4 Shkurt 2017, Moskë, Rusi

Nga 2-4 shkurt 2017 në Moskë, Rusi u zhvillua takimi prezantues i Projektit ELA me pjesëmarrjen e partnerëve të projektit. Gjatë këtij takimi u paraqitën vizioni, qëllimet dhe objektivat e projektit, veprimtaritë e parashikuara në kuadrin e projektit, u prezantua buxheti i projektit dhe u dhanë udhëzime praktike për zbatimin e projektit. Takimi u organizua nga Universiteti i Qytetit të Moskës, Universiteti i Lirë i Brukselit dhe Shoqata Evropiane për Legjislacionin dhe Politikën në Arsim. Sipas programit të takimit, u mbajt edhe leksioni i hapur me temë: “Zhvillimi i të drejtave në arsim të fëmijëve me nevoja të veçanta” nga Elena Shinkareva.



Galeria



Fakulteti i Shkencave Sociale
6,024 likes

Adresa:
Tel:
Fax:
Email: fshs.it@unitir.edu.al
Email: info.fshs@unitir.edu.al

Like Page

Share

Be the first of your friends to like this

